



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

V E N D I M

Nr. 21, Datë 19/01/2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.4, datë 11.01.2022, e z. M.K., ku pretendohet diskriminim, për shkak të bindjes politike² dhe nga ana e Bashkisë Skrapar.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri³,

K O N S T A T O I:

I. Pretendimet sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, ankuesi M.K. ka punuar në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Pastrimit, Gjelbërimit dhe Dekorit në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike të Bashkisë Skrapar nga data 05.07.2011, deri në datën 03.01.2013, datë në të cilën ka kaluar në detyrën e Drejtorit të kësaj ndërmarrjeje. Ankuesi e kryer këtë detyrë deri në datën 03.09.2019, pasi me nëpërmjet Vendimit nr. 36, datë 03.09.2019, të Kryetarit të Bashkisë Skrapar i është zgjidhur kontrata e punës, me motivacion “mosrealizim detyrash”. Sipas ankuesit, ky motivacion është i paprovuar nga Bashkia Skrapar dhe largimi nga puna ka lidhje me anëtarësinë e tij pranë

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Referuar vërtetimit nr. 569/1 prot., datë 09.12.2021, të lëshuar nga LSI, rezulton se ankuesi M.K. është anëtar i subjektit Politik Lëvizja Socialiste për Integrim.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim. Ankuesi sqaron se është anëtar pranë këtij subjekti politik që prej vitit 2008, si dhe është zgjedhur delegat i Konventës Kombëtare për Bashkinë Skrapar në mandatet 4 vjeçare 2016-2020 dhe 2020-2024, si dhe ka qenë anëtar i Komitetit Drejtues Kombëtar për periudhën 2012-2016.

Për sa më sipër, ankuesi pretendon se zgjidhja e kontratës së tij të punës është kryer për motive politike, pasi Kryetari i Bashkisë Skrapar, që ka ardhur në detyrë pas zgjedhjeve të realizuara në muajin qershor 2019, i përket subjektit politik Partia Socialiste. Ky titullar, sipas ankuesit, ka dijani për bindjet e tij politike, pasi ka qenë pjesë e administratës publike të qytetit të Skraparit.

II. Procedurat e ndjekura nga Komisioneri

Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “*bindjes politike*” duke përcaktuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Neni 3, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 12, pika 1, gërma a), b) dhe c), të LMD, i ndryshuar, parashikohet se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe*

mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në nenin 33, pika 4, gërmat dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, parashikohet se nuk pranohen ato ankesa kur: (2) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese. Parashikimi i sipërcituar nuk është kumulativ dhe kërkon si kriter për mospranimin e ankesës, plotësimin e njërit prej kushteve të mësipërme.

Për sa më sipër, KMD ka konstatuar se largimi nga puna i ankuesit ka ndodhur në datën **03.09.2019**. Referuar formularit të ankesës, data **03.09.2019** përkon me datën e ndodhjes së diskriminimit, si dhe datën e marrjes dijani nga ankuesi mbi sjelljen diskriminuese të pretenduar. Ndërkohë që, data e depozitimit të ankesës pranë KMD-së është **11.01.2022**. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se momenti, i marrjes dijani mbi diskriminimin e pretenduar, daton më vonë se 2 (dy) vjet nga data e depozitimit të ankesës nr.4, datë 11.01.2022, së z. M.K. pranë KMD-së.

Mbështetur në dispozitën e sipërpërmendur, Komisioneri nuk e pranon për shqyrtim ankesën nr.4, datë 11.01.2022, e z. M.K., pasi është jashtë afateve ligjore për t’u shqyrtuar nga ky institucion, por rekomandon që ankuesi të depozitojë kërkesëpadi me objekt konstatim diskriminimi pranë gjykatës kompetente⁴, pasi është ende brenda afateve ligjore, që çështja e tij të shqyrtohet gjyqësisht. Në çështje të tilla, Komisioneri thirret nga gjykata në cilësinë e palës së tretë, për të dhënë mendim mbi objektin e shqyrtimit gjyqësor.

⁴ Referuar nenit 36/1, të LMD, të ndryshuar, ku parashikohet: “*1. Padija i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijani për këtë sjellje.*”

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 7, pika 3, nenin 12, pika 1, gërma a), nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr.4, datë 11.01.2022, e z. M.K., pasi është depozituar jashtë afateve ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha - Punësim
Shkak – bindja politike
Lloji i vendimit - mospranim